




REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 329/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi Referues, z Blerim Dina.– Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt: 20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 19.07.2019, të parashtruar nga OE - “Aroma Plus”shpk për tërheqje të ankesës së dt: 20.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Bogdani,Shkolla e Gjellbër dhe Mehmet Xhevari" me nr. Prokurimit: 616-19-620-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “Kuvendi Komunal Prishtinë” me datën 25.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, kërkesa e datës 19 Korrik 2019, e operatorit ekonomik “Aroma Plus”shpk për tërheqjen e ankesës me nr. 329 / 19, të datës 20.06.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Bogdani,Shkolla e Gjellbër dhe Mehmet Xhevari" me nr. Prokurimit: 616-19-620-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Kuvendi Komunal Prishtinë”

II.NDËRPREHET, procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Aroma Plus”shpk me nr. 329/19 të datës 20.06.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Bogdani,Shkolla e Gjellbër dhe Mehmet Xhevari" me nr. Prokurimit: 616-19-620-2-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Kuvendi Komunal Prishtinë”

III.I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, ndërsa nëse ka ankesë tjetër, ajo vazhdon të shqyrtohet në mënyrë të rregullt

dhe aktiviteti i prokurimit mbetet i pezulluar ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së.

IV. Meqenëse aprovohet tërheqja e OE ankues nga ankesa dhe pretendimet ankimore, si dhe duke u bazuar në nenin 30.2 të Rregullores së punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Urdhërohet, OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik “Aroma Plus”shpk ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 20.06.2019, me nr. 329 /19, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Bogdani,Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevari” me nr. Prokurimit: 616-19-620-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Kuvendi Komunal Prishtinë” duke pretenduar se AK-ja, ka bërë shkelje të nenit: 1,6,7 dhe neni 69 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092.

Me datën 20.06.2019, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja për pranimin e ankesës së lartpërmendur lidhur me aktivitetin "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Bogdani,Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevari” me nr. Prokurimit: 616-19-620-2-1-1

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 02.07.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “Aroma Plus”shpk në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, gjatë përpilimit të specifikave teknike duhet të dihet qartë se sa

m2 ka secila shkollë,duke specifikuar dhomat e mësim, korridoret toaletet, kabinetet, sallat sportive, laboratorët etj,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK si njësi matëse për kalkulimin e çmimit ka përcaktuar sipërfaqen në m2, ku tek tabela e përshkrimit të çmimeve ka bërë një ndarje të hapësirave të brendshme, hapësirave të gjelbëruara, hapësirave me asfalt, hapësirave me beton dhe te fushave sportive.

Gjithashtu AK ka ofruar një specifikacion teknik të detajuar lidhur me çdo shkolle duke ofruar informacione detale mbi numrin e mësim dhënësve, numrin e nxënësve, sipërfaqet ne metra katror të kabineteve, korridoreve, klasave dhe shume informacione tjera që janë më se të mjaftueshme për OE gjatë përcaktimit të ofertave të tyre. Konstatohet se ky pretendim ankimor është **i pabazuar**.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK gjatë përcaktimit të kërkesave tekniko profesionale nuk janë të qarta sepse tek neni 9.1 dhe 9.2 ne dosje të tenderit është kërkuar që paga për një punëtor të jetë 275.50 € ndërsa ndërsa tek kërkesat teknike ne njoftimin për kontrate është kërkuar që paga të jetë 282.50 €. AK në dosjen e tenderit të korrigjuar me datë 21.05.2019 tek aneksi i specifikimeve teknike ka kërkuar që paga për një punëtor të jete 275.50 ndërsa në kërkesat për njoftim me kontratë kërkesa ka qenë që paga të jetë 282.50 që ka një mospërputhje në mes të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu ka një mos përputhje në mes te Dosjes së tenderit te datës 21.05.2019 dhe njoftimit për informata shtesë të fundit tek shuma e pagesës së përvojës së punës për listën e punëtorëve nga lista e AK ,në dosje të tenderit është 1,147.00 € ndërsa në njoftimin për informata shtesë është 1,390.00 €.

AK duhet të përcaktoj të dhëna të njëjta si në dosjen e tenderit si në njoftimet për informata shtesë (njoftim për kontratë) në mënyre që OE të kenë qartësi të plotë në përcaktimin e çmimeve në ofertat e tyre. Konstatohet se ky pretendim ankimor është **i bazuar**.

Lidhur me pretendimin e OE se në aktivitetet e ngjashme nga i njëjti AK (pastrimi i objekteve komunale) apo edhe nga aktiviteti i mëparshëm i këtij aktiviteti të prokurimi(i anuluar)janë kërkuar tjera kriteret konsideroj që për çdo aktivitet të prokurimit AK përcakton kriteret/kërkesa që janë të nevojshme për plotësimin e nevojave për atë aktivitet të prokurimit. Krahasoni i kriterëve/kërkesave me aktivitetet tjera të njëjtit AK apo edhe AK tjera është i panevojshëm. Konstatohet se ky pretendim ankimor është **i pabazuar**.

Lidhur me pretendimin e OE se në kërkesën e dosjes se tenderit tek kërkesat teknike "Materialet e përdorura janë te atestuara" ku nga OE ankues është kërkuar që të jepen sqarime se cilat janë këto materiale,konsideroj që AK duhet të ofroj informacione sqaruese për këto materiale në mënyrë që OE të kenë qartësi të mjaftueshme në përcaktimin e ofertave të tyre (çmimeve).

Mos pasja e informacioneve të duhura për kërkesa të vendosura nga AK mund të ndikoj që ofertat e

OE të jenë më të shtrenjta për shkak të mosnjohjes së çka po kërkohet nga këto kërkesa që mund të ishte e dëmshme për vetë buxhetin e AK. Konstatohet se ky pretendim ankimor është **i bazuar**.

OE ankues ka pretenduar edhe në disa ankesa në lidhje me specifikat teknike ku pretendohet se nuk janë kërkuar nga AK (makina dhe pajisje për pastrimin e shkollave), AK në “Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabimi” (Njoftimi i fundit) ka bërë plotësimin e dosjes së tenderit me kërkesa shtesë pikërisht për këto pajisje. Gjithsesi vendosja e kriterëve/kërkesave është në kompetencë të AK në varshmëri me nevojat që duhet të plotësohen nga ky aktivitet i prokurimit. AK duhet të ketë kujdes në përcaktimin e kriterëve/kërkesave duke synuar që për nevojat që kërkohen të plotësohen të kërkohen sa më pak kriterë/kërkesa, sepse vendosja e kriterëve/kërkesave të tepërta mund të kufizojë konkurrencën.

Gjithashtu AK në Njoftimin për kontratë si vlerë të parashikuar ka përcaktuar shumën prej 390,000.00 €, ndërsa në “Njoftimet për Informata shtesë ose Përmirësim i gabimit” edhe pse e ka vazhduar afatin e kontratës nga 12 muaj në 36 muaj, nuk e ka korrigjuar edhe vlerën e parashikuar të kontratës. AK duhet ta korrigjojë vlerën e parashikuar të kontratës sepse edhe kërkesa shtesë tek Kapaciteti ekonomik dhe Financiar ku kërkohet që qarkullimi i mjeteve financiare në tri vitet e fundit të jetë minimum 1,500,000.00 € bie ndesh me vlerën e parashikuar të kontratës (Neni 68 i LPP-së). Konstatohet se ky pretendim ankimor është **pjesërisht pabazuar**.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues të aprovohet pjesërisht për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimit ankimor të më sipërm.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta **PLOTËSOJ / KORRIGJOJ** Dosjen e Tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemali, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevari” me nr. prokurimi 616-19-3237-2-1-1 të iniciuar nga AK-“KK Prishtina” në bazë të dispozitve të LPP-së.

Përfaqësuesi i OE ankues “Aroma Plus” shpk me datën 19.07.2019, ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës, lidhur me tenderin me titull “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemali, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevari” me nr. Prokurimit: 616-19-620-2-1-1 të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues - “Kuvendi Komunal Prishtinë” me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues i ka bërë disa ndryshime në lidhje me kriteret e tenderit, dhe në vendosje se të bëjmë tërheqjen e ankesës së parashtruar në OSHP me datën

20.06.2019. E njëjta është aprovuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së

Paneli shqyrtues, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenkovic



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Kuvendi Komunal Prishtinë”

1x1 OE - “Aroma Plus”shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.